

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Raport sondazhi

Pjesëmarrja qytetare dhe transparenca



Mars 2025

Përmbajtja

Rreth sondazhit	3
Demografia	4
Rezultate	5
Aneks I – Njësitë ku është zhvilluar anketimi	13
Aneks II – Pyetësi i sondazhit	14

Rreth sondazhit

Pjesëmarrja qytetare dhe transparenca institucionale janë elementë thelbësorë për një qeverisje të hapur dhe efektive. Angazhimi aktiv i qytetarëve në vendimmarrje jo vetëm që rrit besimin tek institucionet, por edhe kontribuon në ndërtimin e politikave dhe projekteve që pasqyrojnë realisht nevojat e komunitetit.

Në këtë kuadër, Bashkia e Tiranës ka zhvilluar një sondazh me qëllim vlerësimin e nivelit të përfshirjes qytetare në proceset vendimmarrëse, perceptimin e qytetarëve mbi transparencën e institucionit dhe identifikimin e mundësive për përmirësimin e komunikimit midis qytetarëve dhe Bashkisë.

Ky sondazh u realizua përmes një pyetësori, i cili synonte të mbledhë opinione mbi përvojën e qytetarëve në konsultimet publike, aksesin e tyre në informacionin zyrtar dhe interesin për të marrë pjesë më aktivisht në politikat lokale.

Raporti që vijon përmbledh gjetjet kryesore të sondazhit, duke analizuar perceptimet e qytetarëve dhe duke ofruar rekomandime mbi mënyrat se si Bashkia e Tiranës mund të forcojë transparencën dhe të rrisë përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.

Qëllimi i sondazhit është të evidentojë opinionet e qytetarëve për pjesëmarrjen në konsultimet publike dhe aktivitete, kënaqshmërinë lidhur me nivelin e transparencës dhe informacionit që ofron Bashkia, mënyrat më të mira për të përfshirë qytetarët në vendimmarrje etj.

Objektivat e sondazhit:

- a) Opinionet për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje;
- b) Interesin për pjesëmarrje dhe aksesin në informacion;
- c) Opinionet për transparencën e Bashkisë Tiranë dhe si mund të përmirësohet.


Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës **23 janar – 28 shkurt 2025** dhe u anketuan 700 qytetarë. Anketimi u krye nëpërmjet **intervistave ballë për ballë** me qytetarë rastësorë në 11 njësitë administrative urbane dhe 3 lagjet¹, nëpërmjet një pyetësori² të strukturuar me pyetje të mbyllura dhe të hapura.

¹ Aneks I – Njësitë ku është zhvilluar anketimi


² Aneks II – Pyetësori i sondazhit

Demografia

Të anketuarit për këtë sondazh janë banorë të 11 njësive administrative urbane dhe 3 lagjeve të Tiranës, nga të cilët 50% janë femra dhe 50% meshkuj (*Grafiku Nr.1*).




Anketimi është zhvilluar me qytetarë rastësorë, prej të cilëve 35% janë të moshës 36-50 vjeç, 27% janë 51-65 vjeç, 21% janë 18-35 vjeç, 13% janë mbi 65 vjeç dhe 4% nën 18 vjeç (*Grafiku Nr.2*).




Rezultate


35% e të anketuarve janë përgjigjur se kanë marrë pjesë ndonjëherë në konsultime apo diskutime publike për çështje të organizuara nga Bashkia e Tiranës (Grafiku Nr.3).




Të pyetur për nivelin e përgjithshëm të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, 35% e të anketuarve janë përgjigjur se është mesatar, 28% e vlerësojnë të ulët, 24% nuk kanë dhënë një përgjigje, ndërsa 13% mendojnë se është i lartë (Grafiku Nr.4).




38% e të anketuarve janë përgjigjur se rrallë informohen mbi nismat, projektet, investimet dhe politikat lokale të Bashkisë Tiranë, 30% informohen shpesh, 18% asnjëherë, ndërsa 14% gjithmonë (Grafiku Nr.5).




41% e të anketuarve janë përgjigjur se janë disi të interesuar për t'u përfshirë në vendimmarrjet e Bashkisë Tiranë, 25% janë pak të interesuar, 21% janë shumë të interesuar, ndërsa 13% nuk janë aspak të interesuar (Grafiku Nr.6).



Të anketuarit mendojnë se *përmirësimi i procesit të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje* mund të realizohet duket zbatuar idetë e propozuara nga vetë qytetarët (39%), përfshirja e qytetarëve në proceset buxhetore (38%), gjithëpërfshirja e grupeve të komunitetit si edhe fushata ndërgjegjësimi për rëndësinë e pjesëmarrjes përkatësisht 36% etj. (*Grafiku Nr.7*).




Nivelin e transparencës së Bashkisë Tiranë 45% e të anketuarve e vlerësojnë mesatar, 25% nuk kanë dhënë një përgjigje, 18% e vlerësojnë të ulët, ndërsa 12% e vlerësojnë të lartë (Grafiku Nr.8).




44% e të anketuarve janë përgjigjur se *informacioni publik i ofruar nga Bashkia Tiranë* është disi i aksesueshëm, 27% nuk kanë dhënë një përgjigje, 17% janë shprehur se është lehtësisht i aksesueshëm, ndërsa 12% janë shprehur se *informacioni* është i paaksesueshëm (*Grafiku Nr.9*).

Grafiku Nr.9 Qasja në informacionin publik të ofruar nga Bashkia Tiranë



53% e të anketuarve mendojnë se *transparenca dhe komunikimi i Bashkisë me qytetarët mund të përmirësohet* duke rritur transparencën për proceset vendimmarrëse, 40% mendojnë se duhet komunikim i rregullt përmes mediave dhe rrjeteve sociale, 39% mendojnë se duhen publikime të rregullta etj. (Grafiku Nr.10).



Aneks I - Njësitë ku është zhvilluar anketimi

Anketimi për sondazhin "Pjesëmarrja qytetare dhe transparencë"		
Nr.	Pikat e anketimit	Nr. pyetësorë ballë për ballë
1	Nj.A.Nr.1	50
2	Nj.A.Nr.2	50
3	Nj.A.Nr.3	50
4	Nj.A.Nr.4	50
5	Nj.A.Nr.5	50
6	Nj.A.Nr.6	50
7	Nj.A.Nr.7	50
8	Nj.A.Nr.8	50
9	Nj.A.Nr.9	50
10	Nj.A.Nr.10	50
11	Nj.A.Nr.11	50
12	Lagje 12	50
13	Lagje 13	50
14	Lagje 14	50
Total pyetësorë		700

Aneks II – Pyetësoni i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. i pyetësorit _____

Tiranë, më ____/____/2025

PYETËSOR – PJESËMARRJA QYTETARE DHE TRANSPARENCA

Nj.Administrative/Lagje	Gjinia		Grup-mosha (vjeç)				
	F	M	Nën 18	18-35	36-50	51-65	Mbi 65

- A jeni përfshirë ndonjëherë në konsultime publike apo diskutime për çështje të organizuara nga Bashkia Tiranë (BT)?**
 - Po, shpesh
 - Po, ndonjëherë
 - Jo, por do të doja të merrja pjesë
 - Jo, nuk jam i interesuar
- Si e vlerësoni në përgjithësi nivelin e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje? (Pjesëmarrja në konsultime, diskutime, nisma, fushata etj.)**
 - Të lartë
 - Mesatar
 - Të ulët
 - Nuk e di
- A jeni të informuar mbi nismat/projektet/investimet/politikat lokale të Bashkisë?**
 - Gjithmonë
 - Shpesh
 - Rrallë
 - Asnjëherë
- Sa të interesuar jeni për t'u përfshirë në vendimmarrjen e BT-së?**
 - Shumë
 - Disi
 - Pak
 - Aspak

5. **Si mendoni se mund të përmirësohet procesi i përfshirjes qytetare në vendimmarrje?**
(Mund të zgjidhni më shumë se 1)

- Publikimi i informacionit
- Raporte periodike
- Platforma online të pjesëmarrjes
- Konsultime elektronike
- Gjithëpërfshirja e grupeve të komunitetit
- Fushata ndërgjegjësimi për rëndësinë e pjesëmarrjes
- Përfshirja në proceset buxhetore
- Konsultime të rregullta dhe të hapura
- Zbatimi i ideve të propozuara
- Puna me organizata të shoqërisë civile
- Anketa dhe sondazhe

Tjetër: _____

6. **Si e vlerësoni nivelin e transparencës së BT-së?**

- Të lartë
- Mesatar
- Të ulët
- Nuk e di

7. **Si e vlerësoni qasjen në informacion publik të ofruar nga BT-ja?**

- Lehtësisht të aksesueshëm
- Disi të aksesueshëm
- Të paksesueshëm
- Nuk e di

8. **Në opinionin tuaj, si mund të përmirësohet transparencja dhe komunikimi i Bashkisë?**
(Mund të zgjidhni më shumë se 1)

- Publikime të rregullta
- Publikimi i informacionit në kohë
- Transparencë për proceset vendimmarrëse
- Kanale të dedikuara të komunikimit
- Komunikim të rregullt përmes mediave dhe rrjeteve sociale
- Përmirësimi i mekanizmave të llogaridhënies
- Trajnimi i punonjësve të administratës

Tjetër: _____

Shënim: Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionet për pjesëmarrjen qytetare në konsultimet publike dhe aktivitete, kënaqshmërinë lidhur me nivelin e transparencës dhe informacionit që ofron Bashkia, mënyrat më të mira për të përfshirë qytetarët në vendimmarrje etj.

Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin nr 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"; Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Ligjin nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar".

Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësimit të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.